



**UDHËZUES MBI PROCEDURAT
E REGJISTRIMIT TË PRODUKTEVE
BUJQËSORE DHE USHQIMORE
SI TREGUES GJEOGRAFIKË DHE SPECIALITETE
TRADICIONALE TË GARANTUARA**

Albanian-Swiss Intellectual Property (ALSIP) Project

Prill 2022

UDHËZUES MBI PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË PRODUKTEVE
BUJQËSORE DHE USHQIMORE SI TREGUES GJEOGRAFIKË DHE
SPECIALITETE TRADICIONALE TË GARANTUARA

Albanian-Swiss Intellectual Property (ALSIP) Project

Prill 2022

SHKURTIME

AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ALSIP	Projekti Shqiptaro-Zvicerian i Pronësisë Intelektuale
BE	Bashkimi European
EMO	Emërtim i Mbrojtur i Origjinës
EO	Emërtim i Origjinës
DPPI	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
FAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë
KSC	Komisioni i Skemave të Cilësisë
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OJQ	Organizate Jo-Qeveritare
PI	Pronësi Intelektuale
STG	Specialitete Tradicionale të Garantuara
SAA	Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit
TGJ	Tregues Gjeografik
TGJM	Tregues Gjeografik i Mbrojtur
TRIPS	Aspekte të lidhura me Tregtinë e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale
WIPO	Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

TABLE OF CONTENT

<u>I.</u>	Hyrje.....	3
<u>II.</u>	ÇFARE JANË TREGUESIT GJEOGRAFIK DHE SPECIALITETET TRADICIONALE TË GARANTUARA?..	5
<u>III.</u>	PROCESI I REGJISTRIMIT TË TREGUESVE GJEOGRAFIKË.....	8
	1. Përgatitja e një aplikimi.....	9
	2. Specifikimet e produktit.....	10
	3, Ekzaminimi i formaliteteve.....	13
	4. Ekzaminimi ne substance.....	14
	5. Procedura e kundërshtimit.....	14
	6. Mbrojtja Ndërkombetare.....	15
<u>IV.</u>	PROCESI I REGJISTRIMIT TË SPECIALITETEVE TRADICIONALE TË GARANTUARA.....	18
	1. Përmbajtja e aplikimit për regjistrimin e nje produkti si STG.....	18
	2. Verifikimi i formalitetetve.....	20
	3. Vlerësimi nga Komisioni.....	20
	4. Procedura e kundërshtimit.....	21
	5. Aplikimit për regjistrim në BE.....	21
<u>V.</u>	VERIFIKIMI I PËRPUTSHMERISE ME SPECIFIKIMET E PRODUKTIT PËR STG, EOM, TGJM.....	22
<u>VI.</u>	ANEKSET	28
<u>VII.</u>	Bibliografia.....	30

I. Hyrje

Rregullat për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës (EO), treguesve gjeografikë (TGJ) dhe specialitetet tradicionale të garantuara (STG), për produktet bujqesore dhe ushqimore, janë pjesë përbërëse e politikave për cilësinë agroushqimore.

Përtej bazës ligjore që i konsideron treguesit gjeografik si një kategori e vecantë e të drejtës së pronësisë industriale, ato kanë gjithashtu një rëndësi të vecantë ekonomike. Ato tërheqin vëmendjen e konsumatorëve për të treguar që këto produkte kanë karakteristika dhe vlera specifike. Karakteristikat dhe cilësia e jashtëzakonshme e disa produkteve janë të lidhura me kushtet natyrore të veçanta të një rajoni të caktuar gjeografik dhe metodave të përdorura për prodhimin e tyre: elementet drejt të cilave konsumatorët po shfaqin interes në rritje.

Përveç Treguesve Gjeografikë, një interes gjithnjë në rritje, po tregohet për Specialitet Tradicionale të Garantuar, të cilat edhe pse nuk kanë statusin e TGJ, (megjithëse shumë prej tyre e kanë origjinën nga rajone specifike), shërbejnë për mbështetjen dhe promovimin e produkteve tradicionale.

Shqipëria ka një numër të konsiderueshëm të produkteve unike, që mund të bëhen konkurruese si në tregun e brendshëm ashtu edhe atë ndërkombëtar, nëpërmjet të regjistrimit të tyre si TGJ ose STG.

Mbrojtja e këtyre treguesve të cilësisë synon të ndihmojë prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore të reklamojnë cilësinë e produkteve të tyre tek konsumatorët, të sigurojë konkurrencë të drejtë për fermerët dhe prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore me karakteristika dhe tregues të vlerës së shtuar të cilësisë, si dhe të japë informacionin e nevojshëm për konsumatorin për cilësinë e këtyre produkteve dhe për të siguruar integritetin e tregut.

Si një vend që synon integrimin në BE, Shqipëria ka tashmë një bazë ligjore për regjistrimin dhe mbrojtjen e këtyre produkteve, bazuar në standartet dhe modelet e legjislacionit Europian, duke mundësuar regjistrimin e tyre jo vetëm në nivel kombëtar por edhe në atë ndërkombëtar.

Aktualisht, kuadri ligjor përbëhet nga Ligji Nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale” (i ndryshuar), Rregullorja për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës (miratuar me VKM Nr. 251, datë 24.4.2019), Ligj nr. 8, date 26.2 2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, si edhe aktet e tjera nenligjore që rrjedhin nga ky ligj. **(Aneksi I)**

Ligji “Për pronësinë industriale” dhe rregullorja për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës kanë si qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave lidhur me paraqitjen e aplikimeve për regjistrimin e TGJ dhe/ose EO pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) dhe shqyrtimin e tyre; paraqitjen dhe shqyrtimin e kundërshtimeve, kërkesat për apelimin dhe për shfuqizim, publikimin e të dhënave lidhur me TGJ dhe/ose EO në Buletinin e Pronësisë Industriale, si dhe mbrojtja e këtyre produkteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, Ligji për “Skemat e cilësisë” ka për qëllim të përcaktojë detyrat dhe kompetencat e Ministrisë së Bujqësisë dhe strukturave përgjegjëse për vlerësimin e aplikimeve për regjistrimin e emërtimit “Specialitet tradicional i garantuar”, verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet e produktit për kërkesat për regjistrim të emërtimeve të origjinës dhe të treguesve gjeografikë për produktet bujqësore dhe ushqimore, siç përcaktohet në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”,

verifikimin e përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore me specifikimet e produktit, para vendosjes së tyre në treg, kryerjen e kontrolleve zyrtare për të verifikuar përputhshmërinë e produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara si STG, EOM dhe TGJM me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Ky ligj është i shoqëruar edhe me disa akte të tjera nënligjore që plotësojnë kuadrin për implementimit e skemave të cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore.

Më 26 qershor 2019, Shqipëria depozitoi pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), instrumentin e aderimit në Aktin e Gjenevës të Marrëveshjes së Lisbonës “Për Emërtimet e Origjinës dhe Treguesit Gjeografik”.

Në maj 2019, Shqipëria u bë palë e Marrëveshjes së Lisbonës, çka e bënte aderimin në Aktin e Gjenevës një hap të natyrshëm, veçanërisht kur marrim parasysh se mbrojtja e treguesve gjeografikë është një mënyrë për të mbrojtur njohuritë tradicionale për produktet bujqësore dhe ushqimore.


Regjistrimi ndërkombëtar i emërtimeve të origjinës bëhet nga Zyra Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale, në Gjenevë.

Ky kuadër ligjor kompleks mbulon në përgjithësi të gjitha aspektet që mundësojnë regjistrimin dhe mbrojtjen e produkteve si EOM, TGJM dhe STG, por që është shumë i fragmentuar dhe shumë i vështirë për t'u lexuar dhe kuptuar nga fermerët dhe prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore.

Në këtë kontekst është hartuar ky udhëzues për aplikantët dhe palët e interesuara, për të shpjeguar në mënyrë të thjeshtë kërkesat dhe procedurat për regjistrimin e TGJ, EO dhe STG, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

II. ÇFARË JANË TREGUESIT GJEOGRAFIKË DHE SPECIALITETET TRADICIONALE TË GARANTUARA?

SKEMAT E CILËSISË



Termi "tregues gjeografik", në kuptimin e tij të gjerë, përfshin një sërë konceptesh të përdorura në traktatet ndërkombëtare dhe juridiksionet kombëtare/rajonale, si: emërtimi i origjinës i mbrojtur (EOM) dhe treguesi gjeografik i mbrojtur (TGJM)¹.

Një tregues gjeografik identifikon produktet që kanë një origjinë specifike gjeografike dhe kanë cilësi ose reputacion që i detyrohen asaj origjine. Meqenëse cilësitë varen nga vendi gjeografik i prodhimit, ekziston një lidhje e qartë midis produktit dhe vendit të origjinës së prodhimit.

Ndërsa një Specialitet Tradicional i Garantuar, thekson aspektin tradicional të një produkti, i cili përftohet nga një metodë prodhimi, përpunimi apo ka një përbërje që korrespondon me praktikën tradicionale për këtë produkt bujqësor ose ushqimor, që është prodhuar nga lëndë të para ose përbërës që janë përdorur tradicionalisht.

Politikat e cilësive synojnë të mbrojnë emrat e produkteve specifike për të promovuar karakteristikat e tyre unike, si dhe praktikën tradicionale të prodhimit të tyre.

Aktualisht në vendin tonë, janë identifikuar tre skema të cilësisë së bashku me shkurtimet e tyre: EOM (Emertim Origjine i Mbrojtur), TGJM (Treguesi Gjeografik i Mbrojtur) dhe STG (Specialitete Tradicionale të Garantuara) të perkufizuara qartësisht në Ligjin për Pronesine Industriale (Neni 176) dhe Ligjin për Skemat e Cilësisë së Produkteve Bujqësore dhe Ushqimore (Neni 6).



Skemat TGJ dhe STG janë pjesë e Politikave të Perbashketa Bujqësore (CAP). Këto skema shërbejnë për të promovuar dhe mbrojtur emrat e produkteve cilësore bujqësore dhe ushqimor, ndihmojnë prodhuesit të shesin produktet e tyre me vlerë të shtuar duke siguruar edhe një konkurrencë të ndershme, nxisin prodhim bujqësor të diversifikuar duke kontribuar në ekonomine rurale, mbrojnë emrat e produkteve nga falsifikimi dhe keqpërdorimi, si dhe ndihmojnë konsumatorët duke iu siguruar informacione rreth karakterit specifik të produktit, me një nivel gjurmueshmerie dhe sigurie ushqimore me të lartë në krahasim me produktet e tjera.

¹ https://www.wipo.int/geo_indications/en/

Ndërkohe që TGJ dhe STG kanë një logjike nderhyrje të ngjashme dhe ndjekin të njëjtat objektiva të perbashketa, ato ndryshojnë në disa drejtime. Për EOM dhe TGJM, cilësia dhe reputacioni i emrit të produktit lidhen me origjinën gjeografike, STG mbrojnë aspektet tradicionale të produktit, pa pasur domosdoshmërisht lidhje me një zonë gjeografike të caktuar. EOM dhe TGJM gëzojnë një nivel mbrojtje me të lartë se sa STG, sepse atyre i njihet e Drejta e Pronesise Industriale, që i jep prodhuesve në një zonë të caktuar gjeografike të drejtën për të regjistruar dhe përdorur emrin, nëse përputhet me specifikimet e produktit. Procedurat administrative për regjistrimin e STG janë pothuajse të ngjashme me ato të EOM/TGJM.

EOM quhet emri që përdoret për të treguar një produkt i cili e ka origjinën nga një territor i kufizuar (rajon, lokalitet ose një shtet) cilësia ose karakteristikat e të cilit janë thelbësore ose ekskluzive për shkak të origjinës së tij. Kjo përfshin të gjithë faktorët natyrorë dhe human, si klima, kushtet tokësore, topografia, eksperiencat lokale, etj. Për një EOM, të gjitha hapat e prodhimit të produkteve bujqësore dhe ushqimor duhet të kenë origjinën nga i njëjti rajon. Kjo nënkupton që lënda e parë për një produkt të transformuar EOM duhet ta ketë origjinën nga i njëjti rajon gjeografik.

TGJM janë emra që tregojnë për origjinën e një produkti nga një territor i caktuar (lokalitet, rajon ose një shtet) të cilit mund t'i atribuohet një cilësi e caktuar, reputacion ose karakteristika të tjera që kanë të bëjnë me origjinën e tij. Së paku një nga hapat e prodhimit duhet të ndodhë në territorin e caktuar, që nënkupton se lënda e parë për të prodhuar produktin jo domosdoshmërisht e ka origjinën e rajonit gjeografik të caktuar.

EOM - Emërtimi Origjine i Mbrojtur

Specifikime: Çdo etapë e procesit të prodhimit, përpunimit dhe përgatitjes duhet të zhvillohet në rajonin specifik

Shembull: Vaji i ullirit i Kallamate, i mbrojtur si EOM, prodhohet në rajonin e Kallamates në Greqi dhe nga varietete të ullirit të se njejtës zone.

Logo:



TGJ – Tregues Gjeografik i Mbrojtur

Specifikime: Të pakten një nga etapat e procesit të prodhimit, përpunimit dhe përgatitjes duhet të zhvillohet në rajonin specifik

Shembull: Uiski irlandez (Irish Whisky) është prodhuar, distiluar dhe maturuar në Irlandë që nga shekulli i 6-të, por lëndët e para nuk vijnë ekskluzivisht nga Irlanda.

Logo:



Një emër regjistrohet si STG, nëse përshkruan një produkt bujqësor ose ushqimor të veçantë, i cili përftohet nga një metodë prodhimi, përpunimi apo ka një përbërje që korrespondon me praktikën tradicionale për këtë produkt bujqësor ose ushqimor, që është prodhuar nga lëndë të para ose përbërës që janë përdorur tradicionalisht.

Pavaresisht nga zona e njohur tradicionalisht për prodhimin e produktit, nëse respektohet mënyra tradicionale e prodhimit, ky simbol mund të përdoret nga kushdo qoftë edhe jashtë kufijve të asaj zone.

STG –Specialitet Tradicional i Garantuar

Specifikime: Metoda e prodhimit ose perberesit janë përdorur tradicionalisht, pa u lidhur me një zonë të caktuar gjeografike.

Shembull: «Gueuze» është një birra tradicionale e marrë nga fermentimi spontan. Në përgjithësi prodhohet në dhe afersi të Brukselit, Belgjike. Metoda e prodhimit është e mbrojtur, por mund të prodhohet edhe diku tjetër.

Logo:



III. PROCESI I REGJISTRIMIT TË TREGUESVE GJEOGRAFIK

Kush emërtime nuk mund të regjistrohen si GI?

Ka raste, të parashikuara nga legjislacioni, në të cilat EO/TGJ nuk mund të regjistrohen.

Kjo ndodh para së gjithash me emërtimet që janë bërë gjenerike. Legjislacioni përcakton si gjenerik atë emër, i cili, megjithëse lidhet me emrin e vendit ose rajonit ku fillimisht është prodhuar ose tregtuar produkti bujqësor ose ushqimor, është kthyer në emër të zakonshëm në treg, pavarësisht nëse produkti e ka origjinën në vendin e përcaktuar.

Një rast tjetër përjashtimi nga regjistrimi ndodh kur një emërtim bie ndesh me emrin e një varieteti bimor ose të një race kafshesh regjistruar më parë, gjë që shkakton keqinformim të përdoruesit për origjinën e vërtetë të mallrave.

Së fundi, një shkak i mosregjistrimit të një emërtimi është kur bëhet më e lehtë duke u fshehur pas reputacionit dhe famës së një marke tregtare, si dhe duke përfituar nga përdorimi i saj i mëparshëm në treg; në këtë rast, në fakt, regjistrimi do të keqinformonte konsumatorët në lidhje me identitetin real të produktit.

Në rastin e homonimeve, qoftë edhe të pjesshme, me një emër të regjistruar tashmë si TGJ/EO, regjistrimi i një emri duhet të marrë parasysh përdorimet lokale dhe tradicionale dhe rreziqet aktuale të konfuzionit midis konsumatorëve. Në veçanti, ai nuk regjistrohet kur ata mund të çorientojnë konsumatorin lidhur me origjinën gjeografike, ose kur nuk është mjaftueshëm i diferencuar nga ai i regjistruar më parë.

Nëse emrat e dy ose më shumë vendeve të origjinës së produkteve janë identike apo pothuajse identike, mbrojtja e emrave të tillë si TGJ/EO do të miratohet për të gjithë prodhuesit që plotësojnë kërkesat e ligjit, nëse këto emra janë përdorur në përputhje me praktikën e mira të biznesit dhe informimin e vërtetë të konsumatorit. Përdoruesi i homonimeve do të sigurojë informacion të mjaftueshëm mbi etiketën e materialeve të paketimit, në lidhje me origjinën e vërtetë të produktit, në mënyrë që të dallohet një homonim nga një tjetër dhe të mos çorientohet konsumatori.

Kush mund të aplikojë?

Një aplikim për regjistrimin e Treguesit Gjeografik mund të bëhet nga një grup (pavarësisht nga forma ligjore), i përbërë kryesisht nga prodhuesit apo përpunuesit që punojnë me të njëjtin produkt dhe dëshirojnë të regjistrojnë një tregues gjeografik në lidhje me këto produkte.”

Një person i vetëm fizik ose juridik mund të trajtohet si një grup kur personi është i vetmi prodhues i emërtimit për tu regjistruar, i gatshëm të paraqesë një kërkesë dhe kur zona e përcaktuar gjeografike ka karakteristika, të cilat ndryshojnë dukshëm nga ato të zonave fqinje ose karakteristikat e produktit janë të ndryshme nga ato të prodhuara në zonat fqinje.

Grupet e huaja të prodhuesve mund të depozitojnë aplikim, me kusht që e drejta mbi TGJM ose EOM është dhënë në vendet e origjinës dhe nëse ato plotësojnë kërkesat e këtij legjislacionin në fuqi në Shqipëri.

1. Përgatitja e një Aplikimi

Aplikimi bëhet vetëm për një tregues gjeografik ose emërtimi origjine dhe për një lloj produkti. Aplikimi për regjistrim bëhet nëpërmjet formularit aplikimi për regjistrim emërtimi origjine, dhe formularit aplikimi për regjistrim treguesi gjeografik, **FTGJ1 dhe FEO1²**, respektivisht për TGJ-të dhe EO-të, të nënshkruar nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij dhe dorëzohen në DPPI.

Formularët FEO1 dhe FTGJ1 përmbajnë:

- informacion specifik mbi aplikantin ose përfaqësuesin e tij ligjor (emri, statusi ligjor, kontaktet, etj.)
- specifikimet e produktit. Specifikimet e produktit janë pjesa më e rëndësishme e aplikimit dhe përshkruhet në mënyrë të detajuar më poshtë në “Specifikimet e produktit”.
- autoritetin që verifikon dhe kontrollon përputhshmërinë me specifikimet e produktit;
- përcaktimi i klasës së produktit bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Nicës³ (“Klasifikimi i Nicës”, nënkupton klasifikimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve, i miratuar me marrëveshjen e Nicës më 15 korrik 1957, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme).

Formularin përkatës, shoqërohet edhe me dokumenta të tjera mbështetëse si: prova që produkti e ka origjinën nga zona gjeografike e përcaktuar, lidhja midis cilësisë ose karakteristikave të produktit dhe mjedisit gjeografik ose lidhja midis një cilësie të caktuar, reputacionit ose karakteristikave të produktit me origjinën gjeografike, si edhe çdo rregull specifik për etiketimin e produktit në fjalë.

Rrequllat specifike të etiketimit, kanë të bëjnë me të gjitha elementet specifike, që do të paraqiten në etiketën e një produkti me emërtimin e origjinës apo treguesit gjeografik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për etiketimin.

Aplikimi duhet të përmbajë gjithashtu edhe një dokument zyrtar që vërteton krijimin e grupit, një dokument të lëshuar nga autoritetet vendore, që vërteton kryerjen e veprimtarisë prodhuese të aplikantit në rajonin gjeografik të dhënë, autorizim përfaqësimi (nëse personi që aplikon përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar) si edhe dokumentin e paqesës së tarifës përkatëse.


Në rastin kur aplikanti është një person i vetëm duhet të paraqiten prova që ai është i vetmi prodhues i gatshëm të paraqesë një kërkesë dhe që zona e përcaktuar gjeografike ka karakteristika, të cilat ndryshojnë dukshëm nga ato të zonave fqinje ose karakteristikat e produktit janë të ndryshme nga ato të prodhuara në zonat fqinje.

Elementet thelbësore të aplikimit për regjistrimin EO/TGJ paraqiten në skemën e mëposhtme.

² <http://dppi.gov.al/formularaplikimi/>

³ <https://www.wipo.int/classifications/nice/en/>

ELEMENTET THELBËSORE TË APLIKIMIT PËR REGJISTRIMIN EO/TGJ



2. Specifikimet e produktit

Specifikimi i produktit është elementi kryesor në përcaktimin e emrit të produktit pasi përcakton kushtet që duhet të respektohen më tej nga të gjitha palët e përfshira.

Prodhuesit hartojnë specifikimet për produktin e tyre dhe mbasi ato shqyrtohen nga strukturat përkatëse ato përbëjnë një element të fortë të vetëkontrollit për sistemin e TGJ.

Specifikimi i produktit duhet të përmbajë të gjithë informacionin teknik të nevojshëm për të përshkruar produktin. Ai duhet të jetë mjaftueshëm i detajuar në mënyrë që të lejojë çdo prodhues të ri në fushën përkatëse të fillojë prodhimin e produktit specifik nëse dëshiron.

Specifikimi është prova kryesore në mbështetje të një aplikacioni. Pasi të jenë formuluar, kushtet në një specifikim janë të detyrueshme për prodhuesit që synojnë të përdorin emrin e regjistruar dhe janë pikë referimi për çdo inspektim nga autoritetet. Vetëm produktet që përputhen me specifikimet mund të tregtohen nën emrin e regjistruar EO dhe TGJ.

Specifikimet mund të ndryshojnë në raste kur ka zhvillime të reja shkencore ose teknike, ose nëse një zonë gjeografike ri-përcaktohet.

Emri që do të mbrohet si emërtim origjine ose tregues gjeografik

Emërtimi i produktit bujqësor ose ushqimor duhet të përfshijë emrin e rajonit, të një vendi të caktuar, ose, në raste të jashtëzakonshme, të një shteti (në parim, emri i një shteti nuk mund të regjistrohet; përveçse kur territori i këtij shteti ka karakteristika homogjene në lidhje me ata faktorë që i japin specifikë të veçantë produktit).

Mund të paraqitet edhe si mbiemër (p.sh. "Dibrane", etj). I njëjti emër gjeografik mund të përdoret për produkte të ndryshme. Emri gjeografik duhet gjithashtu të korrespondojë, sa më afër që të jetë e mundur, me zonën e prodhimit të produktit, edhe nëse rastësia e saktë gjeografike nuk kërkohet domosdoshmërisht.

Përveç emrit gjeografik, treguesi gjeografik ose emërtimi i origjinës mund të përmbajë disa të dhëna mbi produktin, siç është emri i tij, lloji (p.sh. mjalte geshtenje i Recit), disa veçori thelbësore, që u japin konsumatorëve informacion shtesë për produktin.

Grupi i aplikantëve duhet të provojë (të paktën për produktet bujqësore apo ushqimore) përdorimin e mëparshëm të emrit në fjalë. Për këtë qëllim, kërkesa për regjistrim duhet të shoqërohet me disa prova si etiketa, reklama, artikuj shtypi etj.

Emërtimi:

- shoqërohet domosdoshmërisht me një zonë të caktuar gjeografike
- është aktualisht në përdorim
- regjistrohet në gjuhën e përdorur historikisht në zonën gjeografike
- terma gjenerike si "natyrale", "tradicionale", "origjinle" etj, përjashtohen nga mbrojtja

Zona Gjeografike

Zona gjeografike përfshin zonën e kufizuar ku prodhohet ose perpunohet produkti. Kjo përfaqëson zonën brenda së cilës merret produkti: siç është përmendur tashmë, në rastin e EOM të gjitha fazat zhvillohen në zonën e kufizuar, ndërsa për TGJM të pakten një nga etapat e procesit të prodhimit, përpunimit dhe përgatitjes duhet të zhvillohet në rajonin specific.

Në përgjithësi, kufijtë e një zone prodhimi/përpunimi përcaktohen nga faktorë natyrorë ose njerëzorë, dhe ndonjëherë nga kufijtë administrativë. Specifikimi i produktit duhet të përcaktojë saktësisht kufijtë e zonës gjeografike, duke përdorur dokumente mbështetëse si hartat, pamje grafike. etj.

Kufizimi i zonës tipike gjeografike, që do të përfshihet në specifikim, duhet të përcaktohet në bazë të vlerësimeve që marrin në konsideratë jo vetëm identifikimin e zonës tradicionale të prodhimit dhe transformimit të produktit dhe homogjenitetin e mjedisit dhe kushtet territoriale që kushtëzojnë veçoritë e vetë produktit, por edhe vlerësimet ekonomike të potencialit prodhues të zonës së identifikuar, për të shmangur që një numër shumë i vogël prodhuesish dhe sasi të pakta produkti të mos justifikojnë kostot e grupimit dhe të kontroleve.

Kufijtë e zonës përcaktohen duke marrë parasysh faktorët natyrorë ose njerëzorë që i japin produktit përfundimtar karakteristikat e tij të veçanta.

Në varësi të uniformitetit të kushteve pedo-klimatike të zonës, delimitimi mund të bëhet duke futur bashki ose krahina të tëra ose duke përcaktuar me përpikmëri kufijtë gjeografikë; megjithatë, nëse nuk ka arsye të bazuara për të vepruar ndryshe, është shumë më e lehtë, edhe për kryerjen e kontroleve, të përcaktohet zona me kufijtë administrativë të bashkive ose krahinave.

Specifikimet duhet të tregojë gjitha shtu se çfarë masash janë marrë për të siguruar gjurmueshmërinë e produktit. Kërkesa kryesore është që aplikanti të deshmojnë një lidhje të qartë midis zonës së prodhimit dhe produktit përfundimtar në treg me dokumente mbështetëse.

Përshkrimi i karakteristikave të produktit

Identifikoni dhe përshkruani se çfarë e bën këtë produkt të veçantë në krahasim me produkte të ngjashme.

Mos të përfshihen veçori të produktit që nuk kanë lidhje me zonën gjeografike ose eksperiencës së prodhuesve, ose nuk kanë asnjë ndikim në reputacionin e produktit. Jepni shembuj konkretë të përdorimit efektiv të emrit, si në të kaluarën ashtu edhe në atë prezente, mundësisht duke përdorur elementë të nxjerrë nga marketingu i produktit.

Përshkrimi në thelb përcakton mënyrat në të cilat një produkt është specifik dhe detajon se si duhet të diferencohet nga produktet e tjera të së njëjtës kategori. Specifikimi i përpunimit, paketimit dhe paraqitjes mund të jetë gjithashtu i rëndësishëm, sepse metodat e prerjes, forma ose paketimit mund të jenë thelbësore për ruajtjen e karakteristikave dhe vlerës së produktit.

Përshkrimi i produktit duhet të përfshijë:

- Atributet fizike (forma, ngjyra, pesha etj)
- Karakteristikat kimike (përmbajtja minimale e yndyrës, përmbajtja maksimale e ujit etj.)
- Informacion mikrobiologjik (p.sh. çdo bakter i pranishëm)

- Detaje biologjike (raca, varieteti etj.)
- Karakteristikat organoleptike (shija, shija, ngjyra, aroma etj.)

Për një produkt të përftuar nga kafshët, të mbrojtur nga emërtimi i tyre i origjinës, specifikimet do të përmbajnë rregulla të hollësishme mbi origjinën dhe cilësinë e ushqimit. Ushqimi duhet të ketë origjinë në zonën gjeografike të përcaktuar.

Përshkrimi është elementi thelbësor që i lejon prodhuesit të respektojnë më mirë karakteristikat specifike të produktit, por gjithashtu vendos një pikë referimi për kontrollet: për këtë arsye informacioni duhet të jepet në mënyrë të qartë dhe koncize, të kufizuar në ato që karakterizojnë vërtet produktin, duke shmangur detajet e panevojshme që veshtiresojne sigurimin e perputhshmerise se produktit me karakteristikat e percaktuara në specifikim.

Përshkrimi i metodës së prodhimit

Përshkrimi i metodave për përfitim e produktit duhet të përfshijë procesin e përfimit të produktit, praktikat e teknikat e përdorura si dhe kriteret e cilësisë së produktit final, duke vënë në pah veçoritë e tij.

Për produktet shtazore përshkrimi duhet të përfshijë informacion mbi kushtet, teknologjitë dhe metodat e mbarështimit (baza foragjere, kullotja, ushqimi, statusi shëndetësor, mosha e therjes, maturimi, klasifikimi i karkasave, pH), si dhe çdo informacion tjetër në përputhje me legjislacionin përkatës.

Për produktet bimore përshkrimi duhet të përfshijë informacion mbi speciet, varietetin, datën e mbjelljes dhe datën e korrjes ose vjeljes, metodën e korrjes ose vjeljes, rendimentin maksimal për hektar, ruajtjen, fortësinë, statusin sanitar, transportin, si dhe çdo informacion tjetër në përputhje me legjislacionin përkatës.

Për produktet e përpunuara përshkrimi duhet të përfshijë informacion për lëndët e para, përbërësit e përdorur në teknologjinë e përpunimit, proceset e prodhimit si dhe çdo informacion tjetër në përputhje me legjislacionin përkatës.

Përshkrimi i metodës së prodhimit duhet të jetë mjaft informues për të lejuar çdo prodhues brenda rajonit të prodhojë produktin në fjalë nëse dëshiron. Kërkesat kryesore janë:

- Mënyra e përfimit të produktit bujqësor apo ushqimor
- Metoda autentike e prodhimit
- Paketimi (aty ku është e rëndësishme)

Prova që produkti e ka origjinën nga zona gjeografike e përcaktuar

Shpjegimi i lidhjes midis produktit dhe zonës gjeografike është elementi më i rëndësishëm i specifikimit të produktit në rastin e TGJ, pasi duhet të tregojë pse një produkt lidhet me një zonë të caktuar dhe jo me një tjetër. Me fjalë të tjera, specifikimi duhet të japë elementet, që justifikojnë lidhjen midis cilësisë ose karakteristikave të produktit dhe mjedisit gjeografik; ose kur është e përshtatshme, lidhjen midis një cilësie të caktuar, reputacionit ose karakteristikave të produktit me origjinën gjeografike. Për TGJ, thjesht

Jepni një arsyetim objektiv që lidh specifikat e zonës gjeografike dhe të produktit. Në rastin e aplikimeve bazuar në reputacionin, tregoni se reputacioni i produktit është i lidhur me emrin dhe i atribuohet zonës gjeografike. Ju mund ta provoni reputacionin me elemente si referenca në libra apo shtyp profesional, përmendje të veçanta në botime gatimi, etj.

të tregosh se zona të caktuara specializohen në prodhimin e një produkti të caktuar ushqimor është justifikim i pamjaftueshëm për një specifikim. Aplikantët duhet të demonstrojnë një lidhje shkakësore midis një zone dhe karakteristikave dhe reputacionit të produktit (p.sh. kushte të veçanta mjedisore ose të tjera), duke përfshirë çdo faktor të qenësishëm natyror ose human.

Në menyre me specifike, për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, specifikimet e produktit duhet të përmbajnë informacion të detajuar për mjedisin gjeografik, duke përfshirë vendin, faktorin natyror dhe njerëzor, si dhe informacion të detajuar për cilësinë ose karakteristikat e produkteve, të cilat vijnë ekskluzivisht ose esencialisht si rezultat i mjedisit gjeografik.

Nëse një aplikim për regjistrimin e treguesit gjeografik është bazuar vetëm në reputacionin e produktit, specifikimet do të përfshijnë evidenca të detajuara për këtë reputacion, duke përfshirë literaturë ose vlerësime të konsumatorit.

Informacioni mbi *faktorët natyrorë* në zonën gjeografike të përcaktuar mund të përmbajë:

- karakteristikat mjedisore, që ndikojnë në teknikat dhe praktikat e prodhimit;
- llojin e nëntokës, tipin e tokës;
- gjeografinë (topografia, pjerrësia, lartësia etj.);
- klimën, mikroklimën;
- bimësinë, peizazhin;
- karakteristikat mjedisore, të përshtatura në llojin e përdorur të përpunimit ose të ruajtjes së produktit.

Informacioni mbi *faktorët njerëzorë* në zonën gjeografike të përcaktuar duhet të përfshijë:

- zgjedhjen e vendeve për aktivitete të kryera nën kushte mjedisore specifike
- rregullim, në përputhje me kërkesat e mjedisit për kulturat bujqësore ose kafshët
- nevojat për prodhime specifike për ndërtim (tharëse, mullinj, hambarë për sanë, etj.);
- zhvillimi i njohurive specifike për teknikat e përpunimit dhe metodat e prodhimit për mbarështimin e kafshëve ose kultivimin e bimëve për përshtatjen e varieteteve apo racave me kushtet mjedisore.

Depozitimi i aplikimit

Aplikimi për regjistrimin e një treguesi gjeografik ose emërtimi origjine depozitohet pranë DPPI-së.

3. Ekzaminimi i formaliteteve

DPPI-ja ekzaminon kërkesat për regjistrimin e TGJ dhe EO, dhe në se ato permbajnë të gjithë elementet e specifikuar nga neni 182 i ligjit për Pronesinë Industriale, e publikon atë në buletin e radhës. Në rast të kundërt, njofton aplikantin për të bërë plotësimet e nevojshme.

Në rast të plotësimit të elementeve të kërkuar nga ana e aplikantit, DPPI-ja publikon elementet kryesore të aplikimit në buletin e radhës. Kur aplikanti nuk kryen plotësimet e kërkuara brenda kohës së caktuar, DPPI-ja refuzon aplikimin për regjistrimin e treguesit gjeografik apo emërtimit të origjinës. Vendimi për refuzim mund të apelohej në Dhomën për Shfuqizim dhe Zhvlerësim.

4. Ekzaminimi në substancë

Në qoftë se aplikimi për një TGJ ose EO i referohet një produkti bujqësor apo ushqimor, DPPI-ja i dërgon kërkesën, me një kopje të dosjes, ministrit përgjegjës për bujqësinë, për vlerësim, në lidhje me specifikimet e produktit. *Komisioni për Skemat e Cilësisë*, i ngritur pranë Ministrisë së Bujqësisë ben vlerësimin në substancë të specifikimeve të produktit për EO-të dhe TGJ-të

Gjatë ekzaminimit, nëse e shihet të nevojshme, mund të kërkojë nga aplikanti dokumente shtesë ose shpjegime të nevojshme për vendimin përfundimtar.

Kur vlerësimi nga organet kompetente është pozitiv, DPPI-ja regjistron treguesin dhe lëshon certifikatën.

Kur vlerësimi është negativ, DPPI-ja refuzon regjistrimin e aplikimit dhe njofton aplikantin i cili ka të drejten e apelit të vendimit në gjykatë.

5. Procedura e kundërshtimit

Çdo person fizik ose juridik që ka interes të ligjshëm mund të depozitojë një kundërshtim ndaj aplikimit, pranë *Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve*.

Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve ekzaminon kundërshtimin në përputhje me kërkesat ligjore dhe pranon ose refuzon kërkesën për kundërshtim duke njoftuar palet e interesuara.

Vendimi i Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të apelohej në *Bordin e Apelit*.

Nëse kundërshtimi ka si objekt specifikimet e një produkti bujqësor ose ushqimor, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve i dërgon dosjen e aplikimit së bashku me dosjen e plotë për kundërshtim ministrit përgjegjës për bujqësinë për miratim, pas plotësimit të të gjitha dokumenteve të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

Nëse aplikanti i TGJ ose EO së kundërshtuar paraqet argumentet e tij ndaj kundërshtimit brenda afatit të parashikuar, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve shqyrton argumentet dhe bazën ligjore, mbi të cilat mbështetet kundërshtimi.

Bazuar në një vlerësim pozitiv në lidhje me aplikimin e kundërshtuar, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve brenda një muaji merr vendim për lëshimin e certifikatës, duke konfirmuar regjistrimin.

Bazuar në një vlerësim negativ në lidhje me aplikimin e kundërshtuar, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mer vendim për refuzimin e regjistrimit dhe njofton aplikantin që ka të drejten e apelimit të vendimit në gjykatë.

Bazat për kundërshtim

Një kundërshtim ndaj një aplikimi për regjistrimin e një TGJ ose një EO do të jetë i pranueshëm vetëm nëse tregon se aplikimi për regjistrimin e TGJ ose EO nuk përmbush kushtet e parashikuara në ligj, kur rrezikon një emër tërësisht ose pjesërisht identik të mbrojtur ose një markë tregtare që gëzon të drejta të mëparshme ose ekzistencën e produkteve, të cilat kanë qenë ligjërisht në treg për të paktën pesë vjet para datës së regjistrimit; ose jep detaje, nga të cilat mund të konkludohet se emri për të cilin kërkohet regjistrimi është një term i përgjithshëm përshkrues.

Ndryshime në specifikimet e produktit

Një grup që ka interes të ligjshëm mund të aplikojë për miratimin e ndryshimeve në specifikimet e produktit duke justifikuar ndryshimet e kërkuara.

Shfuqizimi i një treguesi gjeografik

Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim, me kërkesë të çdo pale që ka një interes të ligjshëm, mund të marrë vendim për shfuqizimin e një TGJM ose EOM në rastet kur nuk ekziston më përputhshmëria me kushtet e specifikimeve të produktit ose kur nuk është hedhur në treg asnjë produkt me këtë TGJM ose EOM për një periudhë kohore të pandërprerë prej shtatë vjetësh.

Përdorimi i Logove

Logot duhet të jenë në etiketën e produkteve bujqësore apo ushqimore të mbrojtura si TGJM apo EOM, shoqëruar me emrin e regjistruar, ndërsa vetë prodhuesit mund të bien dakord për pozicionin e vendosjes së logos në paketimin e tyre.


6. Mbrojtja ndërkombëtare

Treguesit gjeografikë ose emërtimet e origjinës së mbrojtur në Republikën e Shqipërisë mund të mbrohen edhe jashtë vendit në bazë të marrëveshjeve dypalëshe për mbrojtjen e ndërsjellë ose marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Sistemi i Lisbonës është një zgjidhje praktike dhe me kosto efektive për Regjistrimin Ndërkombëtar të Treguesve Gjeografikë, duke ofruar mbrojtje në 37 Palë Kontraktuese, që mbulojnë deri në 56 vende, përmes një procedure të vetme regjistrimi⁴.

Aderimi i Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës në shkurt 2019 dhe në Aktin e Gjenevës një vit më vonë u be për të siguruar që prodhuesit e produkteve cilësore të lidhura me origjinën, të jenë në gjendje të mbrojnë emërtimet e produkteve të tyre në juridiksione të shumta, nëpërmjet një aplikimi të vetëm në Organizatën Botërore të Pronësive Industriale (WIPO) dhe pagesën e një tarife të vetme. Aderimi i BE-së në aktin e Gjenevës përbën një mundësi për Shqipërinë, pasi BE-ja është një nga tregjet kryesor që synojnë produktet shqiptare.

Në përputhje me Aktin e Gjenevës dhe Marrëveshjen e Lisbonës⁵ për regjistrimin ndërkombëtar të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, aplikimet për mbrojtje të një treguesi gjeografik ose emërtimi origjine jashtë vendit mund të paraqiten drejtpërdrejt nga grupet e prodhuesve ose nëpërmjet



DPPI-së me kërkesë të grupit të prodhuesve, vetëm pas regjistrimit të një emri si EOM ose TGJM në territorin e Shqipërisë.

Aplikantët, që kanë siguruar mbrojtje në Shqipëri mbi një emërtim origjine apo tregues gjeografik, do të kenë mundësi që përmes një aplikimi të vetëm të mund të sigurojnë mbrojtje ndërkombëtare në të gjitha vendet anëtare të këtij akti.

Kërkesat që lidhen me aplikimin për

regjistrim ndërkombëtar

Hapat për regjistrimin ndërkombëtar përshkruhen në mënyrë të detajuar në Kapitullin II (Aplikimi dhe Regjistrimi ndërkombëtar) të Aktit të Gjenevës të Marrëveshjes së Lisbonës për Emerimet e Origjinës dhe Treguesit Gjeografik⁶.

Aplikimi përmban (i) kërkesat e detyrueshme dhe (ii) kërkesa opsionale ku paraqitet informacion për lidhjen ndërmjet të karakteristikave të EO/TGJ me origjinën gjeografike.

Formulari i Aplikimit⁷ përmban të dhëna mbi:

- Vendin e origjinës;
- Autoritetin kompetent në vendin e origjinës;
- Përcaktimi EO ose TGJ, për të cilin kërkohet regjistrimi ndërkombëtar;

⁴ https://trade.ec.europa.eu/doclib/docs/2021/february/tradoc_159438.pdf

⁶ https://www.wipo.int/edocs/pubdocs/en/wipo_pub_239.pdf

⁷ <https://www.wipo.int/lisbon/en/forms/>

- Emërtimi i produktit të regjistruar si EO/TGJ në vendin e origjinës ;
- Zona gjeografike e origjinës së produktit
- Detaje të regjistrimit, akti i regjistrimit në vendin e origjinës ;
- Taksa e regjistrimit (1000 CHF)

Aplikimi dorëzohet në Zyrën Ndërkombëtare (International Bureau). Mbas ekzaminimit formal, kur rezulton që aplikimi i permbush kerkesat e percaktuara, regjistrohet në Regjistrin Ndërkombëtar (International Register) dhe dërgon Çertifikatën e Regjistrimit tek Autoriteti Kompetent i vendit të origjinës (kur aplikimi është dërguar nëpërmjet Autoritetit Kompetent) ose direkt tek aplikanti (kur aplikimi është dërguar në mënyrë direkte). Njëkohësisht Zyra Ndërkombëtare njofton edhe të gjithë Palët Kontraktore.

IV. PROCESI I REGJISTRIMIT TË SPECIALITETEVE TRADICIONALE TË GARANTUARA

Skema e Specialiteteve Tradicionale të Garantuara (STG) është krijuar për të mbrojtur metodat tradicionale të prodhimit dhe recetave duke i ndihmuar prodhuesit e produkteve tradicionale për të futur në treg dhe për t'ua përcjellur konsumatorëve atributet e vlerës së shtuar të recetave dhe produkteve të tyre tradicionale.

Në mënyrë që STG-të të përputhen në mënyrë konsistente me specifikimet, duhet që vet grupet e prodhuesve ti përcaktojnë specifikimet e produktit të tyre.

Cilët janë kriteret e regjistrimit të një emri si STG?

Një emër regjistrohet si STG, nëse përshkruan një produkt bujqësor ose ushqimor të veçantë, i cili:

- përftohet nga një metodë prodhimi, përpunimi apo ka një përbërje që korrespondon me praktikën tradicionale për këtë produkt bujqësor ose ushqimor, të paktën prej 30 vjetësh;
- është prodhuar nga lëndë të para ose përbërës që janë përdorur tradicionalisht.

Që një emër të regjistrohet si STG, duhet:

- të jetë përdorur tradicionalisht për t'iu referuar produktit të veçantë;
- të identifikojë karakterin tradicional apo të veçantë të produktit.

Një emër nuk mund të regjistrohet nëse i referohet vetëm termave të përgjithshëm që përdoren për një grup produktesh, ose termave të parashikuar nga një legjislacion i veçantë.

Kush mund të aplikojë?

Kërkesa për regjistrimin e emrave si STG mund të paraqitet vetëm nga një grup që punon me produktet, emrat e të cilave do të regjistrohen.

Një person i vetëm fizik ose juridik mund të trajtohet si një grup kur vërtetohet se personi është prodhues i vetem, që dëshiron të paraqesë një kërkesë.

1. Përmbajtja e aplikimit për regjistrimin e nje produkti si STG

Aplikimi bëhet sipas formularit për regjistrimin e Specialiteteve Tradicionale të Garantuara të miratuar nga Ministria e Bujqëise dhe Zhvillimit Rural

Aplikimi përfshin:

1. Informacion specifik për grupin e prodhuesve ose personit që vepron në emër të grupit; (emrin, adresën, statusin ligjor)

2. specifikimet e produkteve që përfshijnë:

- *emrin* ashtu siç përdoret në treg ose në gjuhën e përditëshme; që një emër të regjistrohet si specialitet tradicional I garantuar, ai duhet të jetë përdorur tradicionalisht për t'iu referuar produktit konkret; ose për të identifikuar karakterin tradicional ose karakterin konkret të produktit.
- *një përshkrim të produktit*, duke përfshirë karakteristikat e tij kryesore fizike, kimike, mikrobiologjike ose organoleptike, që tregon karakterin e veçantë të produktit;
- *një përshkrim të metodës së prodhimit* që duhet të ndjekin prodhuesit, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, natyrën dhe karakteristikat e lëndëve të para ose përbërësve të përdorur ose një mënyrë të veçantë të prodhimit të tyre;
- karakteristikat kryesore që krijojnë karakterin tradicional të produktit.

Elementet kryesore të aplikimit:

- emri dhe kategoria e produktit
- kriteret për regjistrim
- përshkrimi i produktit,
- përshkrim të metodës së prodhimit
- karakteristikat kryesore që krijojnë karakterin tradicional të produktit;

Nga ana tjetër, nuk përmendet lidhja e produktit me territorin, që mundeson, nëse respektohet mënyra tradicionale e prodhimit, ky simbol mund të përdoret nga kushdo qoftë edhe jashtë kufijve të zones se njohur tradicionalisht.

3. kategorinë e produktit bujqësor ose ushqimor, që percaktohet sipas Urdherit Nr. 299, datë 29.7.2020 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për Miratimin e listës së produkteve bujqësore dhe ushqimore për konsum njerëzor, sipas fushës së zbatimit të ligjit nr. 8/2019, datë 26.2.2019, "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore" (p.sh Klasa e III – djatherat). Lista e plote sipas klasave të produktit ndodhet në **Aneksin 2**.

4. informacion mbi procedurën dhe shpeshësinë e kontrollit të përputhshmërisë së produktit me specifikimet

5. një përmbledhje të specifikimeve të produktit;


6. listën e dokumenteve të paraqitura së bashku me kërkesën për regjistrim;

7. dokumenti që konfirmon pagesën e tarifës për regjistrim.

Elementet thelbësore të aplikimit për regjistrimin STG paraqiten në skemën e mëposhtme.

Në ndryshim nga aplikimet për regjistrimin e EO/TGJ, aplikimi për regjistrimin e STG –ve dorezohet në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

ELEMENTET THELBESORË TË APLIKIMIT PËR REGJISTRIMIN STG



2. Verifikimi i formaliteteve

Struktura përgjegjëse prane Ministrisë së Bujqësisë verifikon nëse aplikimi është në përputhje me kërkesat formale të përcaktuara në ligjin për Skemat e Cilesise se produkteve bujqesore dhe ushqimore. Nëse aplikimi për regjistrim i plotëson kërkesat formale, ministria e publikon atë në faqen e internetit të ministrisë dhe ja paraqet aplikimin Komisioni të Vlerësimit.

Kur kërkesat formale nuk plotësohen, aplikuesit i kërkohet nga struktura përgjegjëse të plotësojë mangësitë :

- Nëse mangësitë nuk plotësohen brenda afatit, aplikimi për regjistrim refuzohet dhe njoftohet aplikanti.
- Në rastin kur aplikimi plotëson kërkesat formale, struktura përgjegjëse në ministri njofton aplikantin, e publikon atë në faqen e internetit të ministrisë dhe ja paraqet aplikimin Komisioni të Vlerësimit.

3. Vlerësimi nga Komisioni

Komisioni i Vlerësimit bën vlerësimin dhe merr vendim për aplikimin lidhur me përmbushjen ose jo të kërkesave të përcaktuara sipas kërkesave të përcaktuara në ligj dhe të pershkruara me siper në piken 1. *Përmbajtja e aplikimit për regjistrimin e nje produkti si STG, dhe ja dërgon për miratim ministrit.*

4. Procedura e kundërshtimit

Çdo person fizik ose juridik, që ka një interes të ligjshëm, mund të paraqesë në ministri një kundërshtim ndaj aplikimit për regjistrim me emërtimin STG, duke parashtruar të dhëna që justifikojnë interesin ekonomik ose juridik të personit që paraqet kundërshtimin.

Kur struktura përgjegjëse verifikon se kundërshtimi nuk është në përputhje me kërkesat formale, refuzon kërkesën për kundërshtim dhe njofton paraqitësin e kundërshtimit.

Nëse kërkesat formale plotësohen, struktura përgjegjëse njofton aplikantin që ka paraqitur kërkesën për regjistrim dhe i jep atij mundësinë të paraqesë vërejtje, oponencë, shpjegime ose dokumente shtesë.

Nëse kundërshtimi në lidhje me aplikimin për regjistrim nuk është paraqitur brenda afatit të përcaktuar në ligj, Komisioni i Vlerësimit merr vendim për aplikimin lidhur me përmbushjen ose jo të kërkesave të përcaktuara dhe ja dërgon për miratim ministrit.

Në rastin e paraqitjes së kundërshtimit në lidhje me aplikimin për regjistrim, komisioni shqyrton dhe merr vendim për ligjshmërinë ose jo të kundërshtimit të depozituar.

Nëse aplikimi për regjistrim dhe kundërshtimi janë të justifikuar, struktura përgjegjëse thërret për konsultim aplikuesin dhe kundërshtuesin, që, brenda një kohe të caktuar, të bien dakord ose jo për aplikimin. Kur palët bien dakord, aplikimi i rishikuar paraqitet për regjistrim si aplikim i përbashkët. Ndërsa, kur palët nuk bien dakord, aplikimi refuzohet me urdhër të ministrit.

Vendimi i refuzimit të aplikimit për regjistrim mund të ankimohet në gjykatën kompetente.

Përdorimi i Logos

Emri i regjistruar si STG mund të përdoret nga çdo operator ushqimor që vendos në treg një produkt bujqësor ose ushqimor, i cili është në përputhje me specifikimet përkatëse, të përcaktuara në këtë ligj. Çdo produkt bujqësor ose ushqimor, i çertifikuar për përputhshmërinë me specifikimet për emërtimin STG, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, duhet të etiketohet me shprehjen “Specialitet tradicional i garantuar” dhe logon STG.

5. Aplikimit për regjistrim në BE

Çdo grup, që ka regjistruar në Shqipëri një produkt bujqësor ose ushqimor si STG, mund të paraqesë kërkesë për regjistrim të këtij produkti në BE, sipas formatit të përcaktuar dhe e depoziton në Ministri.

Në rast të kundërshtimit, struktura përgjegjëse njofton menjëherë aplikuesin për marrjen nga Komisioni Evropian:

- a) të njoftimit për kundërshtim, të paraqitura nga një vend tjetër;
- b) të deklaratës së arsyetuar për kundërshtimin e paraqitur.

Aplikanti duhet të paraqesë me shkrim në ministri qëndrimin e tij për kundërshtimin dhe të deklaratës së arsyetuar të kundërshtimit.

Për deklaratën e arsyetuar të kundërshtimit, të parashtruar nga një vend tjetër, komisioni merr vendim për pranueshmërinë ose jo të saj, i cili i dërgohet ministrit për miratim.

Kur aplikimi për regjistrim dhe kundërshtimi janë të justifikuar, struktura përgjegjëse i paraqet vendit që ka paraqitur kundërshtimin propozimin në lidhje me kundërshtimin, të dakordësuar më parë me aplikantin që ka paraqitur kërkesën për regjistrim në BE, si dhe masat e propozuara për të arritur një marrëveshje. Pas paraqitjes së këtij propozimi, ndërmerr hapat për të arritur një marrëveshje dhe informon Komisionin Evropian për arritjen ose jo të marrëveshjes.

V. VERIFIKIMI I PËRPUTHSHMERISE ME SPECIFIKIMET E PRODUKTIT PËR STG, EOM, TGJM

Vlera e shtuar e treguesve gjeografikë dhe e specialiteteve tradicionale të garantuara bazohet në besueshmërinë e konsumatorit, që sigurohet vetëm nëse shoqërohet me verifikime dhe kontrole efektive. Këto skema të cilësisë duhet t'i nënshtrohen një sistemi monitorimi të kontroleve zyrtare, që verifikon përputhshmerinë me specifikimet e produktit.

Autoritetet kompetente për kryerjen e verifikimit të përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, të regjistruara si STG, EOM dhe TGJM, me specifikimet përkatëse, para vendosjes së tyre në treg, janë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ose trupat certifikuese, të miratuara.


Operatori zgjedh nëse verifikimi i përputhshmërisë do të kryhet nga AKU-ja apo një trupë certifikuese e miratuar.

Nëse, pas përfundimit të verifikimit të përputhshmërisë, sipas kërkesave të këtij ligji, rezulton që produkti është në përputhje me specifikimet, AKU-ja ose trupa certifikuese lëshon certifikatën e cilësisë, që konfirmon përputhshmërinë e bujqësore apo ushqimore me specifikimet.


Kontrollet zyrtare për të verifikuar përputhshmërinë e produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara si STG, EOM dhe TGJM dhe monitorimin e përdorimit në treg të emrave të mbrojtur, kryhen nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, që i përfshin në planin vjetor të kontrollit.

Në vijim, paraqitet në mënyrë skematike procesi i regjistrimit të EO/TGJ-ve dhe STG-ve.

PROCESI I REGJISTRIMIT TË TREGUESVE GJEOGRAFIK



PROCESI I REGJISTRIMIT TË SPECIALITETEVE TRADICIONALE TË GARANTUARA



ANEKS I

1. Ligji nr. 8/2019 "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore"

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr.8/2019:

- VKM nr.860, dt.24.12.2019 "Për funksionimin, kohëzgjatjen, organizimin & detyrat e Komisionit për Skemat e Cilësisë".
- VKM nr.677, dt.16.10.2019 "Për miratimin e logos kombëtare për produktet me emërtim "specialitet tradicional i garantuar".
- VKM nr. 231, dt. 19.04.2021 "Perberja, funksionimi, organizimi dhe detyrat e komitetit për aprovimin dhe auditimin e trupave të certifikimit".
- VKM nr. 401, dt. 06.07.2021 për "Percaktimi i kriterëve të detajuara për aprovimin dhe kompetencat e trupave të certifikimit".
- Udhëzim nr. 7, datë 21.4.2020 "Për formën dhe përmbajtjen e regjistrit për produktet bujqësore dhe ushqimore me tregues specialitet tradicional i garantuar".
- Urdhër nr. 299, datë 29.7.2020 "Për miratimin e listës së produkteve bujqësore dhe ushqimore për konsum njerëzor".
- Urdhër nr. 424, dt. 16.10.2020 për "Percaktimin e formës dhe përmbajtjes së certifikatës së cilësisë për përputhshmëriëe produktit bujqësor dhe ushqimor me specifikimet teknike të produkteve të regjistruara".
- Urdhër nr. 425 date 16.10.2020 për "Percaktimin e formatit të aplikimit dhe kundërshtimit të produkteve bujqësore ose ushqimore si STG"

2. Ligji nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar (Kapitulli për treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës).

- VKM nr.251, datë 24.4.2019 "Për miratimin e Rregullores për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e origjinës"

ANEKS 2

LISTA E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE PËR KONSUM NJERËZOR SIPAS FUSHËS SË ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 8/2019, DATË 26.2.2019 "PËR SKEMAT E CILËSISË SË PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE"

Klasa e 1-rë	Mish i freskët (dhe të brendshmet), që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> - mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit; - të brendshmet (zorrët), fshikëzat dhe stomakët e kafshëve (përveç atyre të peshkut), të plota dhe pjesë prej tyre.
Klasa e 2-të	Produkte mishi (të gatuar, të kripur, të tymosur etj.).
Klasa e 3-të	Djathërat.
Klasa e 4-t	Produkte të tjera me origjinë shtazore (vezë, mjaltë, produkte bulmetore të ndryshme
Klasa e 5-të	Vajra dhe yndyrna (gjalpë, margarinë, vaj etj.), që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> - gjalpë, yndyrna dhe vajra të tjera të rrjedhura nga qumështi; - sallo dhe dhjam derri; dhjam i shpendëve; - dhjamë gjedhi, delesh ose dhish; sallo (përfshirë <i>premier jus</i>) prodhuar nga këto dhjamëra; - stearina e sallos së derrit, vaj salloje, oleostearinë, oleo-margarinë dhe vaj prej dhjamt, jo në formë emulsive apo të përzier apo të përgatitura ndryshe; - dhjamëra dhe vajra dhe fraksionet e tyre, të peshkut apo të gjitarëve detarë, nëse janë apo jo të rafinuara; - vajra vegjetale të fiksuara, të lëngshme ose të ngurta, të papërpunuara, të rafinuara ose të purifikuara; - dhjamëra dhe vajra shtazore ose vegjetale, të hidrogjenizuara, të rafinuara ose jo, por
Klasa e 6-të	Fruta, perime dhe drithëra, të freskët apo përpunuar, që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> - frutat dhe arrat e ngrënshme; lëkurat e agrumeve apo të pjeprave; - zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberët përkatës; - drithërat; - produktet e industrisë bluajtëse; mjaltë dhe niseshte; gluten; inulinë; - përgatitje prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjesëve të tjera të bimëve; - niie të tjera të fermentuara (n sh. musht molle, musht dardhe, hidromel);
Klasa e 7-të	Peshk i freskët, molusqe dhe kafshët guaskore dhe produktet që rrjedhin prej tyre.
Klasa e 8-të	Produkte të tjera, që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> - kafe, çaj dhe erëza, përjashtuar mate; - farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe tagjia; - pektin; - sheqer i prodhuar nga kallam sheqeri apo nga panxhar sheqeri në gjendje të ngurtë; - sheqer tjetër, shurupe sheqeri, mjaltë artificial (i përzier ose jo me mjaltë natyral), karamel; - melasat, me lëndë ngjyuese shtesë ose jo; - sheqer, shurupe, melasë me lëndë shtesë aromatizuese dhe ngjyuese, por që nuk
Klasa e 9-të	Ushqime të përgatitura.
Klasa e 10-të	Birrë.
Klasa e 11-të	Çokollatë dhe produkte që rrjedhin prej saj.
Klasa e 12-të	Bukë, torta, kek, ëmbëlsira, biskotat dhe produkte të tjera të furrtarit.
Klasa e 13-të	Pije bërë nga ekstraktet bimore.
Klasa e 14-të	Brumërat.
Klasa e 15-të	Kripë.

Bibliografi

CTA and origin, 2011. Written by Bagal, Monique Ngo, Vittori, Massimo; Practical Manual on Geographical Indications for ACP Countries.

Dashi, E., & Zene, K. 2020. Branding Mishavinë cheese: a contribution of the rural Albanian economy.

Dobi, P., et al. 2016. "Developing goat kid meat value chain based on geographic indications: an approach for rural development in Albania." VII International Scientific Agriculture Symposium, " Agrosym 2016", 6-9 October 2016, Jahorina, Bosnia and Herzegovina. Proceedings. University of East Sarajevo, Faculty of Agriculture, Acta Scientiarum Polonorum. Oeconomia, 19(1).


European Commission 2020, Written by AND International, ECORYS and COGEA, Evaluation support study on Geographical Indications and Traditional Specialities Guaranteed protected in the EU.

FAO, 2012 "Identification of origin-linked products and their potential for development; A methodology for participatory inventories".

Giovannucci, Daniele et al., 2009, Guide to Geographical Indications, Linking Products and their Origins, International Trade Centre, Geneva.

IPR2, 2011, Written by David Thual, and Fanny Lossy, Q&A Manual European Legislation on Geographical Indications

SWG/GIZ, 2020. Short guidelines on the steps and procedures for Registration of Quality products with Geographical Indications and Traditional Specialties.



Publikimi u mundësua nga projekti Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale,
një projekt i Sekretariatit Shtetëror Zviceran
për Çështjet Ekonomike (SECO) i zbatuar
nga Zyra Federale Zvicerane për Pronësinë Intelektuale.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



IGE | IPI